



PALESTINA DHE RËNDËSIA E SAJ

SIPAS SEJID ALI KHAMENEIT

Tiranë, 2023

**Titulli: PALESTINA DHE RËNDËSIA E SAJ SIPAS SEJID
ALI KHAMENEIT**

Autori: Sejid Ali Khamenei

E përktheu: Haxhi Shejkh Vullnet Merja

E redaktoi: Prof. dr. Hajri Shehu

E korrekttoi: Vjollca Karaj

Kopertina: Isra Merja

Përgatiti për shtyp: Sabrie Feza

Botoi: Shoqata "FLLADI"

KREU I PARË:

HISTORIA E PUSHTIMIT TË PALESTINËS

1- Si u uzurpua Palestina?

Në kuadrin e një procesi historik që përfshinte dhjetëra iniciativa të ndërmarra nga armiku, Palestina u shndërrua në pronë absolute të sionistëve. Një numër hebrenjsh me ndikim në botë menduan të krijonin një vend të pavarur për sionistët. Më parë patën menduar të shkonin në Ugandë dhe ta bënin atë vendin e tyre. Për një kohë ata menduan të shkonin në Tripoli, kryeqyteti i Libisë; kështu që biseduan dhe diskutuan me italianët, të cilët atëherë kishin nën kontroll Tripolin, por italianët e refuzuan kërkesën e tyre. Dhe më në fund ranë dakord me anglezët, në atë kohë kishin synime dhe qëllime shumë të rëndësishme koloniale. Ata e panë të përshtatshme që të vinin në këtë zonë, në Palestinë. Pushtimi i kësaj toke qe projekt shumëplanësh dhe kompleks: ai synonte parandalimin e unitetit dhe të bashkimit mysliman dhe parandalimin e krijimit të qeverive të reja të fuqishme nga myslimanët.

Ka prova që tregojnë se sionistët kishin marrëdhënie të ngushta me gjermanët. Dhënia e statistikave të ekzagjeruara për masakrat e hebrenjve që në vetvete një mjet për të fituar simpatinë e publikut, për të përgatitur terrenin për pushtimin e Palestinës dhe për të justifikuar krimet e sionistëve. Madje, ka prova që tregojnë se ata dërguan një numër keqbërësish dhe bastardësh johebrenj nga Europa Lindore në Palestinë, duke i konsideruar ata hebrenj, për të krijuar nën maskën e mbështetjes së të mbijetuarve të masakrave raciste, një shtet antiislamik në zemër të botës islame dhe për të krijuar, pas trembëdhjetë shekujsh, një përçarje dhe ndarje midis botës islame, nga Lindja në Perëndim. Në fillim, myslimanët u befasuan, sepse nuk qenë të vetëdijshëm për natyrën e projektit që synonin sionistët dhe mbrojtësit e tyre perëndimorë.

Perandoria Osmane u mund. Marrëveshja "Sykes-Picot" u bë fshehurazi për të ndarë vendet islame në Lindjen e Mesme midis fituesve të luftës. Lidhja e Kombeve ua la anglezëve mandatin për Palestinën. Anglezët u dhanë premtim pozitiv sionistëve dhe dërguan hebrenjtë në Palestinë përmes një grupi projektsh të studiuar mirë dhe i dëbuan myslimanët nga vendet dhe shtëpitë e tyre.

Fillimisht që planifikuar që hebrenjtë të hynin në Palestinë si pakicë; pastaj gradualisht të shumoheshin dhe të rrëmbenin një pjesë të tokës. Kjo pjesë do të ishte delikate, sepse Palestina shtrihet në një zonë të ndjeshme. Aty

hebrejtë do të formonin një shtet që do të ishte aleat i Britanisë dhe do të pengonte bashkimin e botës islame, veçanërisht, të botës arabe në atë rajon.

Armiku, që mbështetet nga jashtë në këtë mënyrë, mund të mbjellë mosmarrëveshje me spiunazh dhe me metoda të tjera të ndryshme. Kjo është ajo që hebrejtë bënë në realitet duke iu afruar disa personave, duke rrahur të tjerë, duke sulmuar këtë e atë dhe duke terrorizuar të tjerë. Pra, në radhë të parë që kryesisht ndihma e Britanisë dhe e disa vendeve perëndimore. Më pas ata u shkëputën gradualisht nga Britania dhe u bënë aleatë me Amerikën. Amerika i ka mbrojtur sionistët dhe i mbron edhe sot e kësaj dite. Kështu që ata krijuan një vend duke pushtuar Palestinën.

2- E vërteta e mbrapshtë

Në mediat ndërkombëtare u bënë përpjekje për t'i portretizuar hebrenjtë, që pushtuan Palestinën si njerëz, që u qenkan dhunuar të drejtat e që qenkan përballur me presione dhe sulme. Ndërsa arabët, që po përpiqeshin të rifitonin shtëpitë e tyre, paraqiteshin si njerëz mizorë, që flasin me logjikën e forcës dhe nuk u përmbahen standardeve dhe rregulloreve. Përveç kësaj, elementët sionistë dhe amerikanë shfaqnin në mediat e tyre fotografi të disa grave dhe fëmijëve hebrenj të lodhur, në mënyrë që

njerëzit në botë të thoshin: Çudi e madhe! Përse arabët sillen në këtë mënyrë me këta njerëz të varfër e të shtypur?!

3- Shtyllat e pushtimit të Palestinës

Dominimi i sionistëve uzurpues në Palestinë ka tri shtylla:

E para: Mizoria ndaj arabëve

Veprimi i sionistëve ndaj pronarëve vendës, të ligjshëm të tokës ishte i ashpër, i dhunshëm, i skajshëm. Ata nuk silleshin mirë kurrë me ta.

E dyta: Përgënjeshtrimi i opinionit publik

Historia e përgënjeshtimit të opinionit publik është një histori vërtet e habitshme. Ata gënjen e gënjen përmes mediave sioniste deri në atë pikë, sa bënë për vete disa kapitalistë hebrenj për shkak të këtyre gënjeshtreve.

Të shumë qenë ata që i besuan gënjeshttrat e tyre. Ata mashtruan edhe shkrimtarin dhe filozofin social francez Zhan Pol Sartrin, i cili shkroi një libër, të cilin e kam lexuar tridhjetë vjet më parë. Libri titullohet: *Popull pa tokë dhe tokë pa popull*, domethënë: hebrenjtë ishin një popull pa tokë dhe erdhën në Palestinë, që ishte një tokë pa popull.

Çfarë do të thotë *që është tokë pa njerëz*, ndërkohë që aty punonin njerëzit?! Ka shumë dëshmi për këtë. Një shkrimtar i huaj thotë se fushat e grurit ishin në të gjithë tokën palestineze si një det i gjelbër, i dukshëm me aq sa mund të shihte syri. Hebrejtë e mashtruan botën duke thënë se Palestina ishte një tokë e shkretë, e braktisur, e mjerë dhe ne erdhëm atje dhe e populluam dhe e ringjallëm.

Hebrejtë gjithmonë përpiqeshin ta portretizonin veten si të shtypur në revistat amerikane, si "Times" dhe "Neesëeek". Nëse ndodhte ndonjë incident i vogël në një familje hebreje, ata publikonin foto të të vdekurit dhe detaje rreth tij, të moshës së tij dhe e ekzagjeronin padrejtësinë ndaj fëmijëve të tij. Por ata nuk tregonin për qindra apo mijëra raste të dhunës kundër të rinjve palestinezë, familjeve palestineze, fëmijëve palestinezë dhe grave palestineze brenda Palestinës së pushtuar dhe në Liban.

E treta: Marrëveshjet, negociatat dhe përdorimi i lobistëve, siç thonë ata.

Ata takoheshin me këtë a atë qeveri, me këtë a atë personalitet, me këtë a atë politikan, me këtë a atë shkrimtar, me këtë a atë poet dhe bisedonin me ta dhe bënin marrëveshje! Bazuar te këto tri shtylla, arritën ta merrnin këtë vend përmes mashtrimit dhe dinakërisë.

Fuqitë e huaja, me në krye Britaninë, u qëndruan pranë hebrenjve. Kombet e Bashkuara, para saj - Lidhja e

Kombeve, e cila u formua pas luftës për të trajtuar të ashtuquajturat çështje të paqes, gjithmonë i mbështeti hebretë, përveç në disa raste të kufizuara. Në vitin 1948, komuniteti ndërkombëtar nxori një rezolutë që ndante Palestinën pa asnjë arsye e justifikim. Vendimi u dha hebrenjve 57 për qind të tokave palestineze, kur vetëm 5 për qind e tokave palestineze ishin më parë të tyre.

Ata krijuan një shtet atje dhe më pas vazhduan ngjarjet, sulmet ndaj fshatrave, qyteteve, shtëpive dhe njerëzve të pafajshëm. Natyrisht, vendet arabe neglizhuan disi dhe u zhvilluan disa luftëra. Në luftën e vitit 1967, izraelitët, me ndihmën e Amerikës dhe të vendeve të tjera, arritën të pushtojnë pjesë të tokave egjiptiane, siriane dhe jordaneze. Në luftën e vitit 1973, me ndihmën e këtyre forcave, izraelitët, gjithashtu, bënë të mundur të ndryshojnë rezultatin e luftës në favor të tyre dhe të pushtonin më shumë toka.

KREU I DYTË:

RËNDËSIA E PALESTINËS

1- Rëndësia e çështjes palestineze

Nuk ka dyshim se sot, në jetën e myslimanëve dhe në horizontet islame nuk ka asnjë çështje aq të rëndësishme dhe të rrezikshme sa çështja palestineze. Me kalimin e viteve, myslimanët sikur janë mësuar ca nga ca me uzurpimin e një pjesë të vendeve të tyre. Çështja nuk ndalet te uzurpimi i vendbanimeve myslimane. Çështja shkon përtej kësaj. Çështja është se armiqtë e botës islame po përdorin një pjesë të shtëpisë myslimane për të sulmuar radhët e myslimanëve dhe për të vepruar kundër kërkesave dhe lëvizjeve të tyre. Te çështja e Palestinës qëllimi është shpëtimi i Palestinës, domethënë, fshirja e shtetit sionist. Dhe nuk ka asnjë ndryshim në këtë mes tokave para vitit 1967 dhe pas. Çdo pëllëmbë e tokës palestineze është një pëllëmbë e vendeve myslimane. Çdo sovranitet tjetër përveç sovranitetit të popullit të Palestinës dhe sovranitetit të myslimanëve mbi vendin e Palestinës, është sovranitet i uzurpuar.

Hebrenjtë e Palestinës mund të jetojnë atje, nëse pranojnë shtetin islamik. Çështja nuk është e antisemitizmit. Çështja është përdhunimi i shtëpisë myslimane. Nëse liderët myslimanë nuk do t'i ishin nënshtruar ndikimit të fuqive botërore, ata mund ta kishin kryer këtë mision, por, fatkeqësisht nuk e bënë.

2- Rëndësia e Jerusalemit (Kudsit)

Krahas çështjes së Palestinës, rëndësi të madhe ka edhe Jerusalemi. Sot, shumë komplete shumëngjyrëshe po kurdisen nga sionistët për të uzurpuar dhe gëlltitur këtë qytet të shenjtë dhe për të zhdukur monumentet e tij islame. Por ky qytet është për të gjithë myslimanët. I gjithë Jerusalemi është kryeqyteti i të gjithë Palestinës dhe myslimanët nuk do të lejojnë që planet qëllimkëqija të armiqve të realizohen, por ata do të përballen me to.

3- Vizioni i Republikës Islamike të Iranit në lidhje me Palestinën

Nga këndvështrimi islam, çështja e Palestinës është themelore dhe detyrë për të gjithë myslimanët. Të gjithë dijetarët e shkuar dhe të sotëm, shiitë dhe synitë, janë

shprehur se nëse armiqtë e Islamit pushtojnë një pjesë të vendit islam, është detyrë e të gjithë myslimanëve ta mbrojnë atë për të rifituar tokat e uzurpuara. Secili ka detyrën e tij në lidhje me çështjen palestineze - si të mundet. Së pari e ka detyrë nga ana islame. Toka islame, e pushtuar nga armiqtë e Islamit, duhet të rikthehet.

Janë tetë milionë myslimanë, disa prej të cilëve janë dëbuar dhe disa janë në territoret e pushtuara, gjendja e të cilëve është më e keqe se e të dëbuarve. Ata nuk guxojnë të lëvizin normalisht, nuk lejohen të flasin çfarë të duan dhe nuk lejohen të kenë përfaqësuesit e tyre në drejtimin e vendit. Në shumë raste pengohen për faljen e namazit. Sionistët dhunuan xhaminë Al Aksa, kiblen e myslimanëve dhe e dogjën vite më parë. Pastaj ata filluan të gërmojnë në vendin e saj dhe të bëjnë gjëra të pahijshme. Ata përpiqen ta tjetërsojnë xhaminë Al Aksa - kiblen e myslimanëve - nga forma e saj islame.

Nga pikëpamja humanitare, shtypja e familjeve palestineze i vë detyrë çdo njeriu që t'i përkrahë të shtypurit. Sa padrejtësisht e trajtojnë popullin palestinez! Dhe e habitshme është se organizatat e të drejtave të njeriut kanë vdekur!

Këta amerikanë dhe disa nga këta perëndimorë, të cilët mëtojnë (pretendojnë) se mbartin mesazhin e përhapjes së demokracisë në botë, e kanë humbur dinjitetin e tyre në këtë çështje. Është një popull në Rruzullin e Tokës që nuk ka

mundësi të ndikojë në asnjë çështje të punëve të vendit dhe atdheut të vet. Fjalët e tij nuk lexohen e nuk dëgjojnë askund. Ai është populli i Palestinës. Është një popull i shtypur nga pikëpamja njerëzore. Dhe përballë tij është një qeveri raciste që e bën gjithë këtë padrejtësi. Kjo është një disfatë e madhe për Amerikën, për organizatat ndërkombëtare dhe për mendimtarët perëndimorë që pretendojnë se mbështesin demokracinë.

Nga pikëpamja e sigurisë: Izraeli është një kërcënim sigurie, jo vetëm për popullin e tij, por për të gjithë rajonin. Izraeli ka arsenal bërthamor dhe e vazhdon prodhimin. Kombet e Bashkuara e kanë paralajmëruar disa herë, por nuk janë interesuar më tej. Arsyeja kryesore është mbështetja e Amerikës për to. Kjo dotë thotë se, mëkatet e sionistëve dhe të shtetit uzurpues sionist bien kryesisht mbi supet e regjimit amerikan. Gjatë dekadave, kur sionistët morën pushtetin, Këshilli i Sigurimit i OKB-së nxori më shumë se tridhjetë rezoluta kundër Izraelit, por Amerika përdori veton kundër të gjithave.

Izraeli është kërcënim për rajonin nga pikëpamja ekonomike. Sionistët që dominojnë Palestinën, parashtrojnë një tezë, të quajtur "Lindja e Mesme e Re". Cili është kuptimi i Lindjes së Mesme të Re? Kuptimi është: Lindje e Mesme, me epiqendrën e shtetit të Izraelit, ku Izraeli të kontrollojë ekonomisht dhe gradualisht vendet arabe, vendet e rajonit dhe rajonet e naftës në Gjirin Persik. Ky është qëllimi i

izraelitëve. Disa shtete gafile, kur kundërshtohen, thonë: Ne nuk lidhëm marrëdhënie me Izraelin, por i lejuam tregtarët e tyre të vijnë këtu! Kjo është pikërisht ajo që ata duan. Me mbështetjen e Amerikës dhe arsenalin e tij të rrezikshëm, Izraeli dëshiron të shfrytëzojë neglizhencën dhe dobësinë e disa vendeve dhe të hyjë në to dhe të kapë qendrat ekonomike dhe burimet financiare. Plani i sionistëve është të mbështeten tek ekonomia për të kapur të gjitha qendrat e pushtetit në këto vende. Prandaj, prania e Izraelit është një rrezik i madh për popujt dhe vendet e rajonit, qoftë nga perspektiva islame, humanitare, ekonomike, e sigurisë apo politike. Ky është një rrezik shumë i madh për rajonin. Ky është rrezik më i madh se të gjitha rreziqet. Mos e thëntë Zoti që të vijë ajo ditë! Dhe kurrë nuk do të ndodhë sepse popujt myslimanë nuk do ta lejojnë kurrë një gjë të tillë.

4- Imam Khomeini dhe çështja palestineze

Imam Khomeini, që nga fillimi i kryengritjes islame, në vitin 1962, kur çështja palestineze nuk ishte bërë ende e famshme as në elitën e Iranit, thoshte se të gjithë duhet ta ndiejnë rrezikun e hegjemonisë së Izraelit dhe duhet t'i kundërvihen asaj dhe të përballen me të. Dhe vazhdoi në këtë rrugë. Dhe kjo që një nga parullat madhështore të atij njeriu të madh. Kryengritja e Imam Khomeinit (kaddese sirruhu) përhapi një frymë të re në trupin e çështjes

palestineze dhe krijoi për të edhe një herë një burim të besimit islam, të lidhur gjithmonë me xhihadin dhe sakrificën. Imam Khomeini kurrë nuk hoqi dorë nga mbrojtja e të shtypurve të botës dhe sulmet kundër tiranëve të botës. Në testamentin dhe fjalët e tij, Imami i kushton vëmendje thirrjes drejtuar myslimanëve në mbrojtje të të drejtave të të shtypurve dhe mbrojtjes së të drejtave të popullit palestinez dhe të çdo populli tjetër të shtypur. Kjo ishte porosia e imam Khomeinit.

Një nga të rinjtë myslimanë palestinezë ka thënë: Të burgosurit në burgjet e territoreve të pushtuara sot recitojnë poezi nga dashuria për imamin dhe në kujtim të liderit të madh të Revolucionit Islamik. Kujtimi i revolucionit, i imamit dhe kujtimi i xhihadit të popullit iranian janë të përhapura në thellësitë e atyre qelive.

KREU I TRETË:

MBROJTJA E PALESTINËS

1- Rezultati i përçarjes në bashkësinë Islame

Nëse myslimanët do të ishin sot të bashkuar dhe nëse do të mbështeteshin te shpirti i Islamit, armiku nuk do të mund të ushtronte gjithë këtë torturë, presion, persekutim dhe dëm aq të qartë kundër popullit të Palestinës dhe mu në vatrat e tyre. Çështja e Palestinës gjakos zemrën e çdo njeriu që ka zemër, edhe nëse nuk është fetar praktikues. Çështja e Palestinës e largon rehatinë dhe qetësinë.

2- Detyra e mbrojtjes së popullit palestinez

Mbrojtja e popullit të shtypur të Palestinës dhe e kryengritjes së tij të guximshme është detyra islame për të gjithë ne. Sot ekziston një popull mysliman me fytyrë të gjakosur që kërkon ndihmën e Ymetit Islam mu në fushëbetejë. Nuk do ta harroj kurrë klithmën e asaj gruaje myslimane që thirri me zë të ngjirur para kamerës së

reporterit: “O myslimanë!...” Të gjithë myslimanët dhe arabët duhet të mbrojnë legjitimitetin e luftës së popullit palestinez. Në forumet ndërkombëtare duhet theksuar me forcë se njerëzit e pambrojtur, të cilëve u janë grabitur të drejtat dhe që janë nën pushtim, kanë të drejtë të luftojnë për të fituar të drejtat e tyre.

Vazhdimi i kryengritjes dhe i rezistencës nga ana e popullit palestinez është e drejta e tij legjitime që respektohet nga ligjet ndërkombëtare, edhe pse, fatkeqësisht këto ligje zakonisht interpretohen në favor të vullnetit të arrogancës dhe të fuqive botërore. Myslimanët nuk mund të shikojnë shtypjen e përditshme të popullit palestinez dhe të heshtin. Izraeli duhet të kuptojë se vazhdimi i shtypjes së popullit palestinez dhe i zonave të banuara palestineze do të sjellë reagime reale të rënda, serioze nga të gjithë arabët dhe myslimanët.

3- Bota islame dhe çështja palestineze

a- Mbrojtja e Palestinës nga bota islame

Çështja e Palestinës është çështje islame parësore ndërkombëtare. Myslimanët prej vitesh sikur janë mësuar me uzurpimin e tokave të tyre. Çështja nuk është vetëm uzurpimi i tokave myslimane; është më shumë se kaq. Çështja është se armiqtë e botës islame e kanë bërë një pjesë

të tokave myslimane hendek për të sulmuar radhët e myslimanëve dhe për të vepruar kundër vullnetit dhe lëvizjeve të tyre.

Këtu bëhet fjalë për gjendjen e një populli, shpërnguljen e tyre dhe shtypjen e tyre. Fjala është për uzurpimin e një vendi. Fjala është për praninë e një tumori kanceroz në zemër të vendeve islame dhe në pikëtakimin e lindjes dhe të perëndimit të botës islame. Fjala është për padrejtësinë e vazhdueshme brez pas brezi ndaj popullit mysliman palestinez.

Sot, kur kryengritja e përgjakshme islamike në territoret palestineze përfaqëson një rrezik real dhe serioz për pushtuesit gjakatar, metodat e armikut janë bërë më komplekse. Myslimanët në mbarë botën duhet ta marrin shumë seriozisht çështjen dhe të mendojnë për gjetjen e një zgjidhjeje.

Krijimi i shtetit hebre, ose më saktë i shtetit sionist në këtë rajon të botës islame ka në thelb realizimin e një qëllimi afatgjatë kolonializues arrogant. Krijimi i këtij shteti në këtë rajon të ndjeshëm, që përfaqëson pothuajse zemrën e botës islame - sepse lidh perëndimin e botës islame dhe Afrikën me lindjen e saj, Lindjen e Mesme, Azinë dhe Levantin dhe konsiderohet një trekëndësh midis Azisë, Afrikës dhe Europës - u bë për shkak të kontrollit të kolonialistëve në atë kohë ndaj botës islame. Në krye të tyre ishte shteti britanik.

Mënyra e duhur për t'u rezistuar uzurpuesve është ajo që vetë palestinezët kanë gjetur sot me - ndërmarrja e hapave e tyre të vendosur. Është detyrë e të gjithë myslimanëve t'u shtrijnë dorën ndihmëtare në këtë mbrojtje të shenjtë. Nuk ka tradhti më të madhe sot sesa neglizhenca e qeverive myslimane ndaj çështjes palestineze. Shteti uzurpues ka arritur nivelet e tij ekstreme të brutalitetit dhe faraonizmit dhe ka dëshmuar se për të arritur qëllimet e tij të rrezikshme ekspansioniste, është i gatshëm të kryejë çdo krimi. Kryengritja islame e popullit palestinez është argument për të gjithë dhe tregon se, pavarësisht presioneve gjithëpërfshirëse të ushtruara nga armiku dhe tradhtisë së atyre, që pretendonin se ishin miq, fara e qendresës nuk u tha, por, përkundrazi hodhi rrënjë, lulëzoi dhe dha më shumë fryte. Prandaj, është detyrë e të gjithë popujve dhe e të gjitha qeverive që me ndershmëri ta konsiderojnë çështjen islame të Palestinës si një nga çështjet e tyre parësore dhe t'i ofrojnë ndihmë asaj - aq sa munden.

Nuk ka asnjë ndryshim midis të gjitha shkollave të njohura të mendimit islam dhe të gjithë juristët pajtohen se nëse një pjesë e tokës islame pushtohet nga armiqtë e Islamit, atëherë të gjithë duhet ta konsiderojnë detyrë të tyre xhihadin dhe veprën për ta kthyer atë pjesë toke të pushtuar në tokën islame.

Le ta dijë populli palestinez - mbi të cilin sot janë ngulitur sytë e botës islame - se zemrat e Ymetit Islam e

admirojnë, e inkurajojnë dhe luten për të. E, nëse rruga do të ishte e hapur për ndihmë, Ymeti Islam sot do të dërgonte ndihma atje, pavarësisht nëse qeveritë duan apo nuk duan. Ymeti Islam kurrë nuk do të heqë dorë nga Palestina dhe nuk do të mbyllë sytë para të rinjve të Palestinës.

b- Mbrojtja e Palestinës nga qeveritë islamike

Qeveritë myslimane pritet t'i ofrojnë popullit palestinez mundësitë e nevojshme për mbrojtje. Gjithashtu, pritet të bëjnë presion politik ndaj atyre që mbrojnë interesat e sionistëve në botë. Ato mund ta bëjnë këtë në marrëdhëniet e tyre dypalëshe dhe në qarqet ndërkombëtare, në dialogjet publike dhe në negociata private. Për sa kohë që agresori nuk ndalon krimet e tij, populli palestinez - i cili me të drejtë po mbron të drejtat e tij - ka të drejtë të vetëmbrohet.

c- Populli iranian mbron popullin palestinez

Populli iranian i ka mbrojtur gjithmonë popujt e shtypur, që vuajnë nën zgjedhën e arrogancës dhe do të vazhdojë t'i mbrojë ata. Populli iranian qëndron dhe do të qëndrojë përkrah popullit mysliman palestinez, që po luftëton kundër sionizmit kriminel. Populli iranian i këshillon vëllezërit e tij palestinezë që të vazhdojnë luftën kundër armikut pushtues dhe mbrojtësve të tij. Ta vazhdojë këtë rrugë duke u mbështetur te Zoti derisa të eliminohet shteti pushtues sionist. Populli i madh iranian dhe forcat

mobilizuese besnike dhe sakrifikuese në Iran e konsiderojnë mbrojtjen e Palestinës një detyrë fetare dhe nuk e shohin atë si një qëllim, që nuk mund të arrihet.

4- Përdorimi i mediave për të mbrojtur Palestinën

Pas Luftës së Dytë Botërore, hebrenjtë anembanë botës prodhuan qindra apo edhe mijëra filma për të përshkruar padrejtësinë që pësuan dhe për të treguar se ata janë të shtypur dhe ata me të cilët përballen - realisht ose jorealisht - janë shtypës. Padrejtësia me të cilën po përballen populli palestinez asnjë popull tjetër nuk është përballur ndonjëherë. Fatkeqësisht, opinionimi publik nuk është i vetëdijshëm për këtë padrejtësi.

KREU I KATËRT:

ZGJIDHJA E ÇËSHTJES PALESTINEZE

1- Zgjidhja diplomatike e çështjes palestineze

Për problemin e vështirë palestinez, gjithmonë propozohen dy lloje zgjidhjesh. Njëra nga dy zgjidhjet është e gabuar; zgjidhja e dytë është e drejtë. Zgjidhja e gabuar është të negociosh me uzurpatorin, i cili nuk u përmbahet vlerave njerëzore, ligjeve ndërkombëtare, a vendimeve të organizatave ndërkombëtare për të arritur një pikë marrëveshjeje me të. Kjo zgjidhje është e gabuar në çfarëdo mënyre. Izraeli ka vërtetuar se nuk i përmbahet asnjë nënshkrimi, që nënshkruan. Edhe nëse nënshkruan, nuk do u përmbahet marrëveshjeve dhe nënshkrimeve të tij. Një zgjidhje, ku mësymësit i hidhet ushqim në gojë për ta shëndoshur dhe për ta mësyer, kjo nuk është zgjidhje. Kjo është përvoja e shtatëdhjetë viteve të çështjes palestineze. As vendimet e Kombeve të Bashkuara nuk kanë dhënë efekt kundrejt çështjes palestineze. Edhe pse Amerika, e cila mbron sionistët, i ka firmosur këto vendime, uzurpatori nuk i zbaton ato.

Zgjidhja logjike është zgjidhja me të cilën detyrohen të pajtohen të gjitha ndërjegjet e vetëdijshme në botë dhe të gjithë ata që besojnë te konceptet bashkëkohore. Ajo zgjidhje është: Popullit palestinez t'i lejohet të shprehë mendimin e vet. Të gjithë ata që u dëbuan nga Palestina, sigurisht, nëse dëshirojnë, të kthehen në tokën e Palestinës dhe në shtëpitë e tyre. Kjo është zgjidhje logjike. Të zhvendosurit në Liban, Jordani, Kuvajt, Egjipt dhe në pjesën tjetër të vendeve arabe, të kthehen në shtëpitë e tyre në Palestinë dhe të mbahet një referendum, në të cilin të marrin pjesë myslimanë, të krishterë dhe çifutë që ishin në Palestinë para vitit 1948 (viti i themelimit të shtetit të rremë izraelit). Nëpërmjet këtij referendumi të përgjithshëm, të zgjedhin qeverinë që do të qeverisë tokën e Palestinës. Kjo është demokracia. Pse demokracia qenka e mirë dhe e dobishme për të gjithë botën dhe jo për popullin e Palestinës?! Pse të gjithë njerëzit në botë e përcaktojnë vetë fatin e tyre, ndërsa populli i Palestinës nuk paska të drejtë ta bëjë këtë?!

Askush nuk dyshon se regjimi pushtues në Palestinë është sot një regjim që e ka marrë pushtetin me dhunë, me dredhi, me mashtrim dhe me shtypje. Sionistët nuk erdhën me mjete paqësore. Ata erdhën me hile dhe mashtrime, me forcë armësh dhe presion, e janë regjim i imponuar.

Le të mblidhet populli palestinez, të votojë dhe të zgjedhë sistemin e qeverisjes në vendin e vet. Ai shtet dhe ajo qeverisje që do të formohet, të marrë vendim për ata që

erdhën në Palestinë pas vitit 1948, cilido qoftë vendimi i tij. Nëse ai vendos që ata të qëndrojnë, le të qëndrojnë dhe nëse vendos të largohen, le të ikin. Kjo është një zgjidhje që merr parasysh zërat e popullit, demokracinë dhe të drejtat e njeriut dhe është në përputhje me logjikën aktuale të botës.

2- Presioni mbi entitetin sionist

Uzurpuesi nuk e pranon zgjidhjen logjike me gjuhë të sjellshme. Këtu, të gjitha palët në këtë çështje duhet ta konsiderojnë veten përgjegjës - qofshin vendet arabe, vendet islame apo popujt myslimanë në të gjitha anët e botës, veçanërisht vetë populli palestinez, si dhe forumet dhe qarqet ndërkombëtare. Secili ka përgjegjësinë për të ngulmuar në arritjen e kësaj zgjidhjeje logjike dhe të mundshme. Askush të mos thotë se një gjë e tillë qenka ëndërr, fantazi dhe e pamundur. Jo. Është e mundur. Vendet e Detit Baltik u kthyen dhe u bënë të pavarura pas më shumë se dyzet vjet që ishin pjesë e Bashkimit Sovjetik. Edhe vendet e rajonit të Kaukazit, disa prej të cilave ishin nën autoritetin e Rusisë cariste rreth njëqind vjet para themelimit të Bashkimit Sovjetik, u bënë të pavarura: Kazakistani, Azerbajxhani, Gjeorgjia dhe një pjesë tjetër e këtyre vendeve sot janë të pavarura. Pra, është një zgjidhje e mundshme. Por kërkon vullnet, vendosmëri, guxim, njerëz trima, të përgatitur dhe të patrembur. Dhe prandaj,

detyra bie mbi qeveritë. Qeverive arabe u takon të qëndrojnë në ballë dhe në krye të të gjitha qeverive. Qeveritë arabe sot mund të avancojnë dhe të arrijnë dashurinë dhe mbështetjen e popujve të tyre nëpërmjet çështjes palestineze. Nëse aksh shtet e aksh qeveri do të mbështetej nga populli i tyre, atëherë Amerika nuk do të mund t'i bënte asgjë dhe kjo qeveri nuk do t'i frikësohej Amerikës dhe nuk do të kishte më nevojë të hidhte sytë nga Amerika dhe orbita e saj.

3- Përdorimi i armës së naftës

Një nga veprat e rëndësishme që mund të bëjnë vendet arabe është që eksportuesit e naftës të përdorin naftën e tyre. Fjalët që thonë perëndimorët në mbarë botën për mospërdorimin e armës së naftës, nuk janë të vërteta. Nafta është pronë e popullit dhe ai duhet të përfitojë prej saj. Amerikanët i përdorin grurin, kulturat bujqësore dhe ushqimet si armë dhe këtë e bëjnë në shumë rajone të botës. E përse vendet islamike dhe arabe nuk e gëzokan këtë të drejtë?! Në mbështetje të popullit palestinez, qeveritë arabe dhe islame le ta ndërpresin në mënyrë simbolike naftën për vetëm një muaj nga të gjitha vendet, që kanë marrëdhënie të mira me Izraelin! Bota sot posedon lëvizjen - lëvizjen e fabrikave, ndriçimin dhe energjinë elektrike, dhe ngrohjen, të cilat janë tri elementet kryesore të jetës së tyre. Ata i kanë

këto falë naftës së vendeve islame. Nëse nuk kanë naftë, fabrikat, ndriçimi dhe ngrohja do të ndalen.

4- Ndhimja financiare për popullin e Palestinës

Ndhimja financiare për palestinezët nuk është çështje që të thuhet se ky shtet ka paguar dhjetë milionë dollarë, ose njëzet milionë dollarë, ose pesëdhjetë milionë dollarë e më pas të thuhet se ku janë dhënë këto para, si janë dhënë dhe kujt i janë dhënë. Populli palestinez sot ka nevojë për ushqim dhe ilaçe. Populli palestinez nuk është lypës; përkundrazi, është popull fisnik nën autoritetin e pushtuesit të tij. Është detyrë e të gjithëve që ta ndihmojmë këtë popull të shtypur.

Nëse supozojmë se çdo individ në të gjithë botën islame - në Iran dhe në vendet e tjera - i jep vetëm një dollarë popullit të Palestinës, a mund ta imagjinoni se çfarë do të ndodhte?! A e dini se sa efekte do të ketë për popullin e Palestinës dhe jetën e tij një miliardë dollarë? Atëherë, le të përgatiten dhe t'i dërgohen atij ushqime, ilaçe dhe gjithçka që u nevojitet për të përballuar dhe për të rezistuar.

5- Rruga e shpëtimit të Palestinës

Ajo që regjimi sionist pushtues i ka shkaktuar Palestinës dhe popullit të saj në dekadat e fundit është një përvojë e mjaftueshme për të vërtetuar se nuk ka absolutisht asnjë shpresë për të kërkuar ndihmë nga fuqitë që dominojnë botën dhe pasuesit e tyre në rajon për të shpëtuar Palestinën. Revolucioni i Madh Islamik në Iran ka vërtetuar se çelësi për zgjidhjen e problemeve të mëdha është në duart e vetë popujve. Vullneti i njerëzve është ai që do të mbizotërojë mbi masat dhe vullnetin e fuqive dominuese, nëse ata mbështeten te Zoti dhe te premtimet e Zotit. Sot, roli i popujve është dëshmuar më shumë se më parë përmes ngjarjeve që kanë ndodhur në shumë rajone të botës. Përballë brutalitetit të regjimit sionist që ka uzurpuar Palestinën, ekziston vetëm vullneti i popullit palestinez që të qëndrojë i patundur dhe t'i imponojë armikut tërheqje dhe disfatë përmes rezistencës së tij burrërore. Populli palestinez nuk duhet dhe nuk mund t'i kërkojë lirinë dhe të drejtat e tij të vërteta në konferenca dhe takime të liderëve arabë. Nëse këto takime dhe mbledhje janë ogurzeza dhe negative për palestinezët e shtypur, ato janë të padobishme.

6- Rezistenca është rruga për të shpëtuar popullin palestinez

Shpëtimi i Palestinës nuk vjen duke lajkatur Kombet e Bashkuara, fuqitë hegjemoniste apo regjimin uzurpues. Rruga e shpëtimit është vetëm qëndresa dhe qëndrueshmëria, duke bashkuar fjalën e palestinezëve dhe fjalën e monoteizmit, e cila është një pasuri e pafund për lëvizjen xhihadiste. Shtyllat e kësaj qëndrese janë, nga njëra anë, grupet luftarake palestineze dhe të gjithë bijtë besimtarë qëndrestarë të popullit palestinez, brenda dhe jashtë vendit. Dhe, nga ana tjetër, janë qeveritë myslimane dhe popujt myslimanë në të gjitha anët e botës, veçanërisht dijetarët fetarë, intelektualët dhe elitat politike dhe universitare. Nëse këto dy shtylla të fuqishme qëndrojnë të forta, nuk ka dyshim se ndërgjegjet, zemrat dhe mendimet e gjalla, që nuk janë shtrembëruar nga magjia e mediave të perandorisë së lajmeve të arrogancës dhe sionizmit, do t'u vijnë në ndihmë të drejtëve dhe të shtypurve në çdo rajon të botës dhe aparatin e arrogancës do ta vendosin përballë një stuhie idesh, ndjenjash e veprimesh. Qëndresa dhe durimi i muxhahidëve dhe i popullit palestinez, si dhe mbështetja dhe ndihma gjithëpërfshirëse për ta nga të gjitha vendet islame, do të jenë në gjendje të thyejnë më tej hajmalitë satanike për ta uzurpuar Palestinën. Energjia e madhe e Ymetit Islam mund të zgjidhë problemet e botës islame, duke përfshirë problemin e menjëhershëm dhe të ngutshëm të Palestinës.

7- Për fat të mirë, populli palestinez është zgjuar

Zgjimi islamik i popullit palestinez e ka ndriçuar shumë horizontin e së ardhmes. Brezi i ri në rritje i popullit palestinez sot po lufton në emër të Zotit dhe i përmbahet besimit të tij islam. Ky është një xhihad që ngjall shumë shpresë, dhe siç dëshmohet, armiku - qofshin sundimtarët e sionizmit apo të Amerikës, ose pjesa tjetër e mbrojtësve të Izraelit, ose tradhtarët e rajonit - janë të habitur dhe shumë të befasuar nga kjo lëvizje e re. Arroganca kapet pas të gjitha metodave për të shtrembëruar këtë lëvizje dhe për të errësuar drejtimin e vërtetë të xhihadit. Por Islami do ta shpëtojë Palestinën. Islami do ta rimarrë Palestinën nga duart e agresorëve. Brezi i ri palestinez është bërë i vetëdijshëm se nëse dëshiron të triumfojë mbi këtë poshtërim dhe shtypje të imponuar ndaj tij, mënyra për ta bërë këtë është përmes luftës dhe konfrontimit, jo duke u ulur prapa tryezës së bisedimeve, ku negociatorët nuk arrijnë në asgjë.

8- Nacionalizmi arab dhe çështja palestineze

Ndonjëherë dëgjojmë njerëz që thonë se Palestina është çështje arabe. Çfarë do të thotë kjo?

Nëse ajo që nënkuptohet me të është se arabët kanë ndjenja më të afërta dhe më të lidhura dhe janë të gatshëm të ofrojnë shërbime dhe xihad më të madh, atëherë kjo është diçka e dëshirueshme. Por nëse kuptimi i kësaj thënieje është që liderët e disa vendeve arabe të mos i kushtojnë vëmendjen më të vogël thirrjes *O myslimanë!* të bërë nga populli palestinez - ndërkohë që ata bashkëpunojnë me armikun shtypës e uzurpues në një çështje të rëndësishme si për shembull tragjedia në Gaza dhe sulmojnë të tjerët, që nuk mund ta shpërfillin thirrjen e detyrës dhe u bërtasin atyre *Pse po e ndihmon Gazën?* - atëherë asnjë mysliman, as ndonjë arab me ndërgjegje të mirë, nuk do t'i pranojë këto fjalë dhe ata që i thonë, nuk do të jenë të përjashtuar nga faji dhe dënimi.

KREU I PESTË:

PAQJA DHE DORËZIMI

1- Truku i paqes

Truku i sotëm i sionistëve dhe i mbrojtësve të tyre - sigurisht që qeveria amerikane është mbështetësi i tyre më i rëndësishëm, është përdorimi i fjalës së bukur “paqe”. Paqja, natyrisht është një gjë shumë e mirë. Po ku është paqja dhe me kë?! Hyn një person në shtëpinë tuaj dhe ju thyen me forcë derën, ju rreh, ju fyen familjen dhe fëmijët tuaj dhe merr dy dhoma e gjysmë nga tri dhomat tuaja për të banuar, pastaj ju thotë *pse ankoheni për këtë pa arsye e pse kundërshtoni e grindeni gjithmonë, ejani të pajtoheni dhe të jetojmë në paqë!* A kjo është paqja?! Agresioni është natyra e regjimit sionist, i cili u krijua dhe vepron mbi bazën e forcës, të dhunës dhe të mizorisë. Po të mos ishin këto baza, ky regjim uzurpues nuk do të ishte aty ku është sot. Ata thonë: Le të pajtohen me këtë regjim! Nëse sionistët janë të bindur për të drejtën e tyre - domethënë, nëse ata ua lënë atdheun, që është Palestina pronarëve të saj dhe shkojnë në punët e tyre, ose nëse marrin leje nga qeveria palestineze që një

numër ose të gjithë të qëndrojnë në atë vend – atëherë, askush nuk do t'i luftojë ata. Lufta bëhet se ata hynë me dhunë dhe përdhunim në shtëpitë e të tjerëve dhe i dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe tani po i shtypin. Edhe sot e kësaj dite, ata vazhdojnë të shtypin të gjitha vendet e rajonit dhe përbëjnë një kërcënim për të gjithë. Kështu që, ata e duan paqen si një premisë për agresionin e mëvonshëm. Nëse ka paqe, kjo është një premisë që më pas të sulmojnë dhe të përdhunojnë në një mënyrë tjetër.

2- Projekti i dorëzimit të Palestinës përballë Izraelit

Një nga çështjet e parashtruara tani, për ta lënë në harresë çështjen e Palestinës dhe për të mos lejuar që ajo të ngrihet në opinionin publik të Ymetit Islam, janë këto të ashtuquajturat negociata paqeje, që janë duke vazhduar midis një grupi palestinezësh dhe izraelitëve. E kemi fjalën për procesin e dorëzimit dhe qeverinë e të ashtuquajturit *Autoriteti Palestinez*. Ky, nga ana tjetër, është një nga kurthet dhe mashtrimet më të shëmtuara izraelite, ku, për fat të keq kanë rënë një numër myslimanësh dhe palestinezësh. E përse? Sepse, mbi bazën e supozimeve më të mira, nëse të gjitha detyrimet që izraelitët morën mbi vete, do të përmbusheshin në një nga negociatat që ata zhvilluan, ajo që do të merrte ai grupi palestinez është pak më shumë se

katër për qind e tokës së Palestinës! Kjo do të thotë se nga kjo tokë palestineze, e cila është tërësisht pronë e palestinezëve, atyre u takon katër për qind e saj! Dhe ky katër për qind nuk është në një vend, por i shpërndarë në pjesë të veçanta!

Ata njerëz që u thanë të vinin dhe të formonin një autoritet, nuk i lejuan kurrë të vepronin si qeveri. Ata i kërkuan të shkonin atje dhe të monitoronin palestinezët në atë zonë që të mos ishin aktivë kundër qeverisë izraelite! Pra, atyre iu dha një zonë e vogël, e shpërndarë, e kufizuar dhe jo e plotë, që nuk mund t'u menaxhoka si vend! Ajo që ata duhet të bëkan në këmbim, është të punojnë kundër muxhahedinëve palestinezë brenda territoreve të pushtuara, përveç asaj që po bëjnë shërbimet izraelite të sigurisë! Tradhtia e atyre që kryejnë veprime të tilla në emër të palestinezëve është më e shëmtuar, më e tmerrshme dhe më e keqe se të gjitha tradhtitë e deritanishme ndaj Palestinës. Ata ende nuk kanë bërë asgjë për popullin e Palestinës dhe nuk mund të bëjnë asgjë.

3- Logjika e dorëzimit të arabëve përballë Izraelit

Qeveritë arabe thoshin: Ne nuk jemi më palestinezë se vetë palestinezët! Ajo që kërkojnë palestinezët, duhet ta bëjnë vetë palestinezët.

Çështja e Palestinës është çështja e botës islame. Është çështje e një detyrim hyjnor dhe islam - përveç aspekteve politike, ekonomike dhe të sigurisë. Mbi gjithçka, ajo është çështje hyjnore. Por, edhe nëse një person nuk beson në Zot dhe dëshiron të punojë vetëm për popullin e Palestinës, ai duhet të shohë se çfarë thotë i gjithë populli palestinez. Populli palestinez është sot ai, fëmijët e të cilit janë të burgosur në burgjet e regjimit uzurpues. Ka dhe dhjetëra herë më shumë prej tyre që ngrenë zërin dhe kryejnë operacione në rrugë, në xhaminë Al Aksa, në tregje dhe në të gjitha tokat e uzurpuara. Ka një pakicë të vogël, që u lakmua dhe shkoi dhe iu dorëzua armikut. Këta nuk janë populli palestinez, që të mund të thuhet se ne nuk jemi më palestinezë se bijtë e Palestinës.

4- Arsyeja e dështimit të kryengritjes së parë

Në atë kohë - në kohën e Kryengritjes (intifadës) së Parë - një atmosferë dorëzimi u përhap gradualisht në rajon:

Zemrat e disa njerëzve anonin nga Amerika. Një grup tjetër besonte se nuk ishte e mundur të përballuhej ai presion politik dhe atmosfera e pafavorshme ndërkombëtare dhe se nuk kishte rrugë tjetër, veçse të pranonte dorëzimin në kushtet e diktuar nga Amerika dhe Izraeli. Pas zhvillimeve që dëshmoi rajoni në atë kohë, u krijua terreni për ta çuar më tej këtë teori. Në kohën e Kryengritjes së Parë gjithmonë propozoheshin dy metoda për t'u marrë me Izraelin:

E para, konfrontimi ushtarak midis ushtrive arabe dhe ushtrisë izraelite - në të cilin thuhet se të gjitha përvojat e mëparshme të ngjashme ishin të dështuara.

E dyta, metoda e dorëzimit që çon në përmbushjen e kërkesave të Izraelit me mjete paqësore dhe siguron që aftësitë ushtarake të vendeve arabe të mos rriten në këmbim të tërheqjes së tij nga një pjesë e territoreve të pushtuara - ngjashëm me atë që ndodhi në Camp David. Modeli i rezistencës nuk ishte në tavolinë në atë kohë dhe thuhej se nuk gëzonte pranim të përgjithshëm.

5- Rezultatet e projektit të dorëzimit në Oslo

Në Kryengritjen e mëparshme, populli palestinez pësoi humbje të mëdha dhe dha shumë dëshmorë dhe shumë njerëz u bënë të paaftë fizikisht për hir të Islamit dhe të çlirimit të tokës islame. Bisedimet e Oslos e ndaluan

përfundimisht Kryengritjen. Madje, as planifikuesit dhe mbrojtësit palestinezë të Oslos nuk e mbrojnë më sot, sepse praktikisht e kuptuan se Izraeli kishte për qëllim vetëm të zgjidhte problemin e tij, pra të shpëtonte nga konfrontimi me muxhahidët e gurit dhe të zvogëlonte dobësinë dhe brishtësinë e tyre. Nëse i dha diçka të paktë palës palestineze dhe e quajti dhënie privilegjesh, atëherë kjo ishte vetëm për të shuar zjarret e Kryengritjes dhe për të zvogëluar goditjet që Izraeli mori.

Sapo izraelitët zbuluan se problemi i tij ishte zgjidhur dhe gabimisht e ndjenë se populli palestinez nuk ishte më në gjendje të rifillonte kryengritjen (intifadën), rezistencën dhe konfrontimin me ta, ata ndaluan së dhëni edhe ato privilegje të thjeshta dhe shfaqti lakminë e tij. Procesi i dorëzimit dhe projekti i Oslos e vendosën popullin e Palestinës në një gjendje që u dëshmoi atyre se nuk kishin zgjidhje tjetër, veç revolucionit.

6- Tradhtia ndaj çështjes palestineze

Po bëhen përpjekje për ta harruar plotësisht atë që quhet populli palestinez. Sikur nuk ka tokë që quhet Palestinë apo ndonjë popull që e zotëron këtë tokë! Kështu e përgatitën sionistët rrugën! Njerëzit shohin me çudi, konfuzion dhe keqardhje të madhe se disa njerëz dorëzohen! Kjo është ajo që po ndodh sot. Sionistët sjellin

një grup të quajtur palestinezë në një pjesë të tokës së madhe të Palestinës dhe u japin atyre atje - pra në katër përqind të vendit të Palestinës - sovranitet të rremë, jo të plotë, sipërfaqësor, joreal dhe në këmbim sionistët kërkojnë prej tyre të harrojnë çështjen e Palestinës dhe tokën e popullit. Çdo palestinez që përmend emrin e popullit palestinez, vendin e Palestinës apo historinë e Palestinës shtypet nga të njëjtët njerëz që bënë këtë marrëveshje humbëse!

7- Tradhtia e Palestinës nga sundimtarët arabë

Sionistët dhe mbrojtësit e tyre, me në krye Shtetet e Bashkuara të Amerikës, morën në dorë situatën e iniciativës për ngritjen e parullave të dorëzimit dhe vazhdimin e pushtimit uzurpues të Palestinës dhe i çuan kundërshtarët e tyre ku deshën.

Në të kaluarën, disa qeveri myslimane, deri edhe vendet e vijës së parë, goditën me hanxharet e tyre nga pas shpine! Heshtja e kënaqshme e shumicës së krerëve të vendeve arabe, e shoqëruar ndonjëherë edhe me tradhti të plotë - përveç pozicioneve poshtëruese dhe tradhtare të atyre që pretendojnë të udhëheqin popullin palestinez, janë hallka të ndërlidhura në zinxhirin e tradhtisë, të padrejtësisë, të agresionit që kërkon ta mbajë tokën islame të Palestinës të uzurpuar përgjithmonë dhe populli i saj i

plagosur e i shtypur të jetë gjithmonë i burgosur dhe i shpërngulur.

Heshtja dhe dorëzimi tradhtar i shumë qeverive arabe - disa prej tyre shfaqeshin edhe indiferente dhe alergjike ndaj fatit të Palestinës, i çuan punët deri në pikën ku regjimi uzurpues sionist guxoi të pretendonte sërish dhe publikisht Izraelin e Madh, pasi e kishte mbajtur këtë për vite të tëra në fshehtësi dhe mbulim. Izraeli i përsëriti me paturpësinë më të madhe qëllimin e tij të ndyrë që ishte uzurpimi i tokave të tjera të vendit islam, Palestinës.

KREU I GJASHTË:

LUFTA DHE REZISTENCA

1- Fuqia e popullit

Arroganca kolonializuese nuk e di se ka një fuqi përtej fuqisë së armëve të tyre. Është fuqia e popujve. Nëse njerëzit besojnë te parimet dhe vlerat e vërteta me vendosmëri të patundur, atëherë asnjë fuqi, qoftë edhe fuqia atomike, nuk do të arrijë t'i mposhtë ata. Shtypësit nënvlerësojnë fuqinë e popujve dhe fuqinë e Allahut të Plotfuqishëm, që qëndron para vullnetit, vendosmërisë dhe iniciativave të popujve. Në ajetin 20 të sures "Isra" Allahu thotë: **"Ne i mbështesim të gjithë edhe këta, edhe ata. Dhuratat e Zotit tënd nuk i mohohen askujt."** Çdo grup që punon për qëllimet në të cilat beson do të ndihmohet dhe përkrahët nga Allahu i Plotfuqishëm. Nëse një grup beson në Allahun, përballja me të dhe mposhtja e tij do të jetë dhjetë herë më e vështirë.

2- Lufta heroike e popullit palestinez

Lufta që filloi populli palestinez, nuk është luftë e një ushtrie kundër një ushtrie tjetër, për të thënë se sa tanke ka kjo dhe sa tanke ka ajo tjetra. Është një luftë e trupave dhe e shpirtrave të njerëzve, që nuk i frikësohen vdekjes. Çdo i ri sakrifikon e i del përballë regjimit pushtues, e kërcënon po aq sa një ushtri e tërë. Ata që nuk mund t'i përgjigjen këtij të riu me tanke, raketa, avionë dhe helikopterë "Apaçi". Edhe një individ i vetëm, që nuk i frikësohet vdekjes dhe përgatitet të sakrifikojë për hir të Allahut dhe të detyrës, ai përfaqëson rrezikun më të madh për padronët e padrejtë të botës. Ky shpirt i martirizimit nuk është rezultat i ndjenjave dhe emocioneve, por është rezultat i besimit në Islam, në jetën pas vdekjes në Ditën e Gjykimit. Kudo që ekziston Islami në kuptimin e tij të vërtetë, ky rrezik për arrogancën është i pranishëm. Arroganca është e detyruar të luftojë për dominim mbi Palestinën. Lufta me Islamin do të thotë luftë kundër botës islame. Dhe është një luftë që nuk ka rezultat. E vërteta e çështjes është se sionistët dëbuan dhe shpërngulën një popull nga vatrat dhe jetët e tyre. Dhe ky popull ka të drejtë të kthehet e të rifitojë vatrat e tij dhe të kthehet në vatrat e tij. Është një luftë e vërtetë. Dhe Amerika e quan terrorizëm, por arrogancën e sionistëve kundër muxhahidëve palestinezë nuk e quan terrorizëm!

Populli palestinez është sot një popull i shtypur, por shumë i guximshëm, pavarësisht nga shtypja. Ai e meriton

të quhet Populli heroik palestinez. Palestinezët janë një popull që reziston i vetëm ndaj pushtuesit sionist. Arroganca globale, e armatosur me të gjitha armët e vrasjes dhe të shtypjes janë bërë të paaftha përballë këtij populli heroik.

3- Boshti kryesor i luftës kundër regjimit sionist

Vija e përgjithshme e luftës kundër regjimit uzurpues sionist duhet të jetë izolimi i tij brenda kufijve të territoreve të pushtuara, kufizimi i frymëmarrjes së tij ekonomike dhe politike, shkëputja e lidhjeve të tij me mjedisin përreth, vazhdimi i rezistencës dhe i luftës që populli i Palestinës po bën brenda vendit të tij dhe ofrimi i të gjitha formave të ndihmës për këtë popull deri në arritjen e fitores përfundimtare.

4- Modeli i muxhahidinëve palestinezë

Palestina është pushtuar më se shtatëdhjetë vjet më parë. Palestina pati rininë e saj edhe shtatëdhjetë vjet më parë. Ky i ri palestinez që hyn pa frikë në fushën e betejës, kush e mësoi atë dhe cili është modeli i tij? Modeli i tij është besimtari i ri, muxhahid, besnik në Liban. Në demonstratat që zhvillohen në Rripin e Gazës dhe Bregun Perëndimor të

lumit Jordan - që janë zonat e banuara nga palestinezët - ata ngrënë fotografi të liderit të Hizbollahut në Liban, Sejid Hasan Nasrallah. Ata ngrënë flamurin e Hizbollahut libanez mbi kupolën e xhamisë Al Aksa. Sigurisht, sionistët nuk e lejuan Flamurin të qëndronte atje, por, gjithsesi u vendos te kupola e Xhamisë Al Aksa. Dhe kështu i riu u bë model për të rinjtë palestinezë. Televizioni *Al Manar*, i lidhur me Hizbollahun, regjistron numrin më të madh të shikuesve brenda territoreve të pushtuara të Palestinës, të cilët jo vetëm i ndjekin programet e tij, por pinë prej tij si i eturi, sikur të jetë ujë i pastër dhe shërues.

5- Xhihadi është detyrë e Bashkësisë Islame

Të gjithë juristët thonë: Nëse armiku pushton një vend mysliman dhe kërcënon entitetin islam në një vend mysliman, atëherë është detyrë e të gjithë myslimanëve që të luftojnë kundër armikut në kuadër të një xhihadi të madh e gjithëpërfshirës, ta dëbojnë atë dhe ta dënojnë atë. Ymeti Islam duhet të kthehet te vetvetja dhe të zgjohet. Përgjumja e tij është fatkeqësia më e madhe që u ka rënë myslimanëve në kohët e sotme.

Asnjë mysliman nuk e vë në dyshim vendimin e zbatueshëm për çështjen palestineze. Është një çështje e përmendur në të gjithë librat e jurisprudencës islame që trajtojnë temën e xhihadit. Nëse jobesimtarët do të vinin dhe

do të pushtonin ose do të rrethonin një vend mysliman, asnjë nga juristët e hershëm apo të sotëm myslimanë nuk do të hezitonte të merrte parasysh detyrimin specifik të xhihadit. Të gjitha shkollat (medhhebet) e mendimit islam njëmendësohen për këtë kuptim. Xhihadi fillestar është një detyrë e mjaftueshme, por në raste të tjera, xhihadi mbrojtës, i cili është forma më e dukshme e mbrojtjes, është detyrë personale.

6- Kryengritja e Xhamisë Al Aksa

Kryengritja e parë u ndal nën ndikimin e sugjerimeve të sionistëve dhe mbrojtësve të tyre, premtimeve se palestinezët do të merrnin privilegje me mjete paqësore dhe presioneve të Amerikës dhe Perëndimit. Kalimi i dhjetë viteve nga ajo datë vërtetoi se të gjitha përpjekjet e mbrojtësve të sionizmit në botë kishin për qëllim shpëtimin e regjimit izraelit nga presionet e xhihadit, të kryer nga myslimanët dhe se ajo që ata u premtuan negociatorëve palestinezë nuk ishte asgjë, veçse një mirazh, një iluzion. Kryengritja e Xhamisë Al Aksa është fillimi i një zhvillimi të madh në luftën e popullit palestinez.

Qëndresa palestineze ka provuar shtigje plot kthesa, ka kaluar nëpër lloj-lloj makinacionesh dhe sfidash të vështira dhe veshët e saj janë mbushur me shingrellimat e

armëve dhe zhurmën e avionëve dhe të artilerisë armike. Sot e ka kuptuar shumë mirë se e vetmja mënyrë për t'u çliruar nga kthetrat e kriminelëve dhe mbështetësve të tyre është xhihadi, rezistenca e vazhdueshme dhe opinioni publik islam që e pranon dhe e përkrah këtë strategji.

Boshti kryesor i Kryengritjes (Intifadës) Al Aksa është Jerusalemi. Pra, shkëndija që çoi në shpërthimin e zemërimit të popullit palestinez ishte fyerja e xhamisë Al Aksa nga sionistët. Për të ruajtur një nga vendet më të shenjta për myslimanët, populli palestinez doli në skenë dhe me vetëmohimin dhe sakrificën e tij ndezi pishtarët e shenjtë të rezistencës dhe të luftës kundër pushtuesit sionist. Konteksti i dorëzimit - dhe projekti i Oslos në veçanti çoi në ndarje midis palestinezëve. Por Kryengritja e bekuar që rivendosja e unitetin kombëtar në arenën palestineze. Në këtë luftë morën pjesë të gjitha segmentet e popullit. Rrymat islame dhe kombëtare u rreshtuan përkrah njëra-tjetrës.

7- Faktori i rilindjes palestineze (Kryengritja e Xhamisë Al Aksa)

Nuk është Republika Islamike apo populli i Libanit që çoi në revolucionin palestinez. Faktori i revolucionit palestinez janë vetë palestinezët. Arsyeja e rilindjes dhe e kryengritjes palestineze është dhimbja dhe shqetësimet e

akumuluaru te brezi i ri, që sot ka hyrë në arenë me shpresë dhe gjallëri.

Populli iranian i admiron, i bekon dhe i konsideron si vetat e tyre popullin palestinez. Palestina është pjesë e trupit të Islamit dhe populli iranian ndien lidhje vëllazërie dhe gjaku me rrinë palestineze dhe me popullin palestinez. Këta të rinj janë ata që bëjnë kryengritje.

8- Palestina është boshti i zgjimit islam

Rilindja Islame, ose, të themi Zgjimi Islamik u shfaq me forcë të plotë në rajon dhe në botën islame pas fitores së Revolucionit Islamik në Iran dhe lëvizjes së Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*). Boshti kryesor i kësaj rilindjeje dhe i kryengritjeve është çështja palestineze. Kryengritja Al Aksa mundi të tërhiqte të gjithë popujt myslimanë dhe arabë në arenë, madje edhe jashtë kufijve gjeografikë të Palestinës dhe jashtë fushëveprimit të popullit palestinez.

Demonstratat milionëshe të popujve myslimanë të botës islame - nga Perëndimi në Lindje për të shpallur mbrojtjen dhe përkrahjen e tyre për Intifadën e Xhamisë Al Aksa, dëshmuar se populli palestinez mund të mbështetet në ndihmën e tyre. Njëherësh ato luajtën rol të dukshëm për unitetin mes myslimanëve.

Ditën kur u formua Rezistenca Islame në Liban me përpjekjet e burrave heroikë libanezë dhe me rekomandimin dhe mbështetjen e Imam Khomeinit, Izraeli po pushtonte Bejrutin, kryeqytetin e Libanit dhe po kontrollonte aftësitë politike të këtij vendi. Kur Rezistenca Islamike në atë kohë hodhi sloganin "Marsho, marsho, marsho drejt Jerusalemit", disa injorantë i përshkruan ata si mendjelehtë dhe shtruan pyetjen: A është e mundur të marshosh drejt Jerusalemit kur ju, libanezët, nuk jeni në gjendje të hyni në kryeqytetin tuaj? Që nga ajo datë deri në fitoren historike të rezistencës islame mbi Izraelin kanë kaluar vetëm 18 vjet dhe 18 vjet nuk janë një kohë e gjatë në historinë e luftës së popujve.

9- Rezistenca është kusht për çlirimin

Kryengritja e Xhamisë Al Aksa që një kryengritje popullore që vërtetoi se palestinezët kishin hequr dorë nga të gjitha metodat e dorëzimit dhe zbuluan se fitorja varej vetëm nga rezistenca. Rezistenca - si një model i suksesshëm para syve të Ymetit Islam - mundi për herë të parë të çlironte territoret e pushtuara pa i dhënë asnjë privilegj Izraelit dhe pengoi regjimin sionist të arrinte dëshirën e tij për të ngritur flamurin e tij në tokën e kryeqytetit të këtij vendi arab, pra, të Libanit.

Në Camp David, kushti për tërheqjen e Izraelit ishte që ushtria egjiptiane të mos shkonte në veri të Sinait. Por në Libanin jugor, Izraeli ishte i shqetësuar për forcën e rezistencës islamike dhe kërkoi me lutje që ushtria libaneze të dërgohej në kufi, mes Palestinës dhe Libanit. Kjo do të thotë se Rezistenca islamike ishte në gjendje të rivendoste plotësisht sovranitetin kombëtar libanez në Libanin Jugor dhe pjesën tjetër të territoreve të pushtuara.

THËNIE TË NDRYSHME TË IMAM SEJID ALI KHAMENEIT PËR PALESTINËN

Të dashurit e mi!

Ky krim, uzurpimi i Palestinës, paraqet një faqe të njollosur të historisë që do të mbyllet si faqet e tjera të ndotura, me lejen dhe ndihmën e Zotit të Madhëruar. Në ajetin 81 të sures “Isra” Zoti i Madhëruar thotë: **“Pa dyshim, e pavërteta do të zhduket”**. Kurse në ajetin 105 të sures “Enbija”, Allahu Fuqiplotë thotë: **“Tokën e trashëgojnë robtë e Mi të drejtë.”**

Të dashurit e mi!

Ne nuk e konsiderojmë sionizmin si qëllim, doktrinë, as tendencë çifute, por si një tendencë agresive politike fashiste, që nuk mund të vazhdojë jetën e saj veçse përmes shtypjes, padrejtësisë dhe marrjes së viseve që u përkasin myslimanëve të shtypur dhe të privuar.

Të dashurit e mi!

Ju e vëreni qartë sot se ata filluan një luftë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse kundër gjithë kombit islam, jo vetëm një pjese të tij. Kjo luftë ka dimensione ekonomike, politike, kulturore, ushtarake dhe të sigurisë. Ajo që shihni sot në Palestinë, Irak a Afganistan nuk është luftë vetëm kundër një populli, sepse kur ata luftojnë Palestinën, në fakt po luftojnë entitetin e Islamit në këtë rajon. Kur ata e pranojnë regjimin sionist dhe e mbështesin atë me gjithë qenien e tyre, kjo është për shkak se ata duan të vendosin një pengesë të madhe për unitetin dhe fuqinë e botës islame.

Të dashurit e mi!

Ata thonë pse Irani e mbështet popullin e Palestinës? Ne i mbështesim të gjithë. Ne kemi mbështetur popullin palestinez për 32 vjet. Populli ynë ka shprehur kudo ndjenjat e tij për Gazën, Palestinën, Egjiptin dhe Tunizinë. Dhe këto vende nuk janë shiite. Pra, çështja nuk është çështje shiite dhe sunite.

Të dashurit e mi!

Ngritja e çështjes së Palestinës nuk është një proces taktik për Republikën Islamike, por është një çështje

themelore dhe rrënjësore e saj, që rrjedh nga besimi islam. Është detyra jonë ta nxjerrim këtë vend islamik nga autoriteti dhe nga kthetrat e fuqive uzurpuese dhe e mbështetësve të tyre ndërkombëtarë dhe t'ia japim popullit të Palestinës. Kjo është detyrë fetare për të gjithë myslimanët. Është detyrë e të gjithë popujve dhe qeverive islame që ta bëjnë këtë.

Të dashurit e mi!

Bota islame duhet të ketë solidarësi për të mbështetur popullin palestinez. Palestina është bërë më e gjallë se më parë në vetëdijen dhe zemrat e myslimanëve.

Të dashurit e mi!

Vrasja e grave, burrave, fëmijëve dhe pleqve palestinezë, përdhosja e shenjtërisë së Xhamisë Al Aksa, shtypja dhe rrahja fizike e besimtarëve myslimanë në xhami dhe inkurajimi i kolonëve sionistë për të sulmuar popullin e pambrojtur të Palestinës; janë prej krimeve më të zakonshme dhe më të përditshme që kryen regjimi sionist. Në rrethana të tilla përball këtyre krimeve, a kishte rrugë tjetër populli palestinez, me dinjitet dhe lashtësi disa mijëra vjeçare, përveçse të fillonte një stuhi të madhe?

Të dashurit e mi!

Lëvizja që u nis në Palestinë, do të përparojë dhe do të sjellë fitoren e plotë të palestinezëve. Ngjarjet e ditëve të fundit në Palestinë, veçanërisht bombardimet e përsëritura dhe martirizimi i grave, fëmijëve dhe burrave lëndojnë zemrën e njeriut. Por një pjesë tjetër e këtyre ngjarjeve tregon fuqinë mahnitëse të Islamit në Palestinë.

Të dashurit e mi!

Sot, në rastin e Gazës, të gjithë ne kemi përgjegjësinë të reagojmë. Duhet të reagojmë. Mijëra njerëz janë të uritur, janë nën bombardime dhe po martirizohen. Një studiues ose një universitet duhet të përpiqet të njohë të vërtetën dhe t'i qëndrojë asaj. Të shikosh me indiferentizëm këtë çështje, nuk është e lejueshme për dijetarët dhe shkencëtarët.

Të dashurit e mi!

Nëse këto krime vazhdojnë, myslimanët dhe forcat e rezistencës nuk do të durojnë dhe askush nuk do të jetë në gjendje t'i ndalojë ata.

Të dashurit e mi!

Fuqitë arrogante ndjekin forma politike dinake e mashtruese. Kjo është një praktikë e njohur historike. Ata

nuk pengohen nga vlerat morale, as nga ndjenjat njerëzore sepse i ka rrëmbyer ambicia e tyre e pahijshme. Këtë e shohim edhe sot me qëndrimin e tyre ndaj masakrave barbare në Palestinë.

Të dashurit e mi!

Armiku barbar dhe gjakpirës nuk merr parasysh kurrfarë kufiri në vrasjen dhe masakrimin e fëmijëve, grave, burrave, pleqve e të rinjve; prandaj popullsia civile e Rripit të Gazës është, me kuptimin e thellë dhe të vërtetë të fjalës një popullsi e shtypur dhe viktimë.

Të dashurit e mi!

Populli i Gazës është, me të vërtetë i shtypur dhe ky armik i pamëshirshëm dhe gjakatar - regjimi terrorist uzurpues nuk njeh kufij për krimet: Vret mijëra njerëz të pafajshëm me bombardim.

Të dashurit e mi!

Regjimi i plagosur dhe i gjunjësuar pushtues izraelit po hakmerret për goditjen e rëndë që e pësoi nga luftëtarët e rezistencës palestineze duke vrarë civilë në Rripin e Gazës.

Të dashurit e mi!

Palestina është pjesë e kombit islam dhe pushtimi i Palestinës do të thotë se është pushtuar një pjesë e tokës islame. Krijimi i shtetit sionist u arrit nga arroganca globale kundër kombit islam. Është detyrë e të gjithë myslimanëve që të kontribuojnë në këtë luftë dhe të ofrojnë mbështetje për atë pjesë të trupit islam që është në duart e armikut.

Të dashurit e mi!

Përpyekjet, shtypjet dhe krimet e sionistëve janë të kota dhe nuk do të çojnë askund. Në të ardhmen Palestina do t'u përkasë palestinezëve, jo regjimit sionist.

Të dashurit e mi!

Fuqitë hegjemoniste të botës po e shikojnë se regjimi sionist është duke u shembur dhe shkatërruar si pasojë e goditjes së madhe dhe vendimtare të luftëtarëve të rezistencës palestineze; prandaj, pikërisht për këtë arsye, me ecejaket e tyre dhe duke shprehur solidaritetet dhe duke i vendosur në dispozicion të gjitha mjetet për kryerjen e krimeve, si bombat dhe armatimet e ndryshme, ato po mundohen ta mbajnë në këmbë regjimin e plagosur dhe të gjunjëzuar sionist.

Të dashurit e mi!

Fryma e besimit dhe motivi i xhihadit për hir të Zotit, kur u bashkuan me qëndrueshmërinë e popullit palestinez, krijuan pengesën më të madhe për realizimin e planeve të arrogancës globale.

Të dashurit e mi!

U bëj thirrje vëllezërve palestinezë dhe motrave palestineze: Vazhdoni luftën tuaj, vazhdoni qëndrueshmërinë dhe rezistencën tuaj, sepse pavarësia dhe identiteti nuk arrihet, veçse me vendosmëri dhe qëndresë.

Të dashurit e mi!

Populli palestinez, me rezistencën, qëndrueshmërinë, trimërinë dhe palodhshmërinë e tij, ka dëshmuar aftësinë e gjakut për të qëndruar kundër shpatës.

Të dashurit e mi!

Fuqia e arrogancës vjen nga bombat, presioni ushtarak, mizoria dhe krimi. Por fuqia e besimit me ndihmën e Zotit do t'i mposhtë të gjitha këto.

Të dashurit e mi!

Populli i Gazës, me qëndrimin e tij lëvizi ndërgjegjen njerëzore. Sot ju shihni se edhe në rrugët e Amerikës dhe të vendeve perëndimore, turma të mëdha po brohorasin kundër Izraelit dhe në shumë raste - kundër Amerikës.

Të dashurit e mi!

Populli palestinez u zgjua dhe triumfi do të jetë aleati i tyre.

Të dashurit e mi!

A është terrorist kushdo që mbron shtëpinë e tij dhe vendin e tij?! A ishin terroristë francezët që luftuan gjermanët në Paris në Luftën e Dytë Botërore?! Si është e mundur që ata janë luftëtarë dhe një burim krenarie për Francën, ndërsa të rinjtë e Xhihadit dhe Hamasit qenkan terroristë?!

Të dashurit e mi!

Brezi në rritje në Palestinë e zgjodhi rrugën me gjemba me bindje dhe me kënaqësi.

Të dashurit e mi!

Sionistët e konsiderojnë veten racë superiore dhe e shohin me përçmim pjesën tjetër të njerëzimit; prandaj kanë masakruar mijëra fëmijë pa asnjë brejtje ndërgjegjeje!

Të dashurit e mi!

Veprimi kryesor është ky: Duhet të ndërpriten damarët dhe kanalet jetike të regjimit pushtues sionist dhe qeveritë e vendeve islame duhet të pengojnë në mënyrë serioze mbërritjen e energjisë dhe të mallrave të ky regjim pushtues.

Të dashurit e mi!

Rrethanat aktuale të rajonit - më shumë se në të kaluarën - kanë nevojë për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet vendeve të rajonit dhe të mos ndikohen nga politikat e induktuara nga faktorët e huaj.

Të dashurit e mi!

Bota e ardhshme është bota e Palestinës, jo e uzurpatorit sionist dhe e ardhmja u takon palestinezëve. Sa

u përket përpjekjeve që bëjnë uzurpatorët, duke kryer padrejtësi, krime e mizori - të gjitha janë të kota dhe nuk do të arrijnë asnjë rezultat, insha' Allahu. Shpresojmë që Zoti i Plotfuqishëm të bëjë atë që është më e mira për botën islame, për kombin islam dhe t'i pikëllojë, t'i shtypë e t'i poshtërojë armiqtë e kombit islam.

Të dashurit e mi!

Çështja e Palestinës, me ndihmën e Zotit, është duke lëvizur drejt zgjidhjes, çka do të thotë drejt formimit të shtetit të Palestinës në të gjithë territorin e Palestinës. Pikëpamja e Republikës Islamike të Iranit nuk është "hedhja në det të askujt", por është formimi i një shteti, duke u mbështetur në mendimin dhe votën e popullit të Palestinës.

Të dashurit e mi!

Shejtani i arrogancës është kujdesur ta përhapë frontin e tij në të gjitha vendet e botës. Ai i ka ndërlidhur të gjitha çështjet e jetës njerëzore dhe i ka prekur të gjitha grupet njerëzore në shoqëri. Me frontin e shejtanit, kam parasysh materializmin perëndimor, që planifikojnë prijësit e së keqes dhe të arrogancës, i cili bazohet në interesat e pronarëve të kompanive të mëdha, te kapitali i madh, te tirania e tyre dhe te pangopësia e tyre.

Përmbajtja

| | |
|--|-----------|
| KREU I PARË: Historia e pushtimit të Palestinës..... | 5 |
| 1- Si u uzurpua Palestina?..... | 5 |
| 2- E vërteta e mbrapshtë..... | 7 |
| 3- Shtyllat e pushtimit të Palestinës..... | 8 |
| KREU I DYTË: Rëndësia e Palestinës..... | 11 |
| 1- Rëndësia e çështjes palestineze..... | 11 |
| 2- Rëndësia e Jerusalemit (Kudsit)..... | 12 |
| 3- Vizioni i Republikës Islamike të Iranit në lidhje me Palestinën..... | 12 |
| 4- Imam Khomeini dhe çështja palestineze..... | 15 |
| KREU I TRETË: Mbrojtja e Palestinës..... | 17 |
| 1- Rezultati i përçarjes në bashkësinë Islame..... | 17 |
| 2- Detyra e mbrojtjes së popullit palestinez..... | 17 |
| 3- Bota islame dhe çështja palestineze..... | 18 |
| 4- Përdorimi i mediave për të mbrojtur Palestinën..... | 22 |
| KREU I KATËRT: Zgjidhja e çështjes palestineze..... | 23 |
| 1- Zgjidhja diplomatike e çështjes palestineze..... | 23 |
| 2- Presioni mbi entitetin sionist..... | 25 |
| 3- Përdorimi i armës së naftës..... | 26 |
| 4- Ndihma financiare për popullin e Palestinës..... | 27 |
| 5- Rruga e shpëtimit të Palestinës..... | 28 |

| | |
|---|-----------|
| 6- Rezistenca është rruga për të shpëtuar popullin palestinez..... | 29 |
| 7- Për fat të mirë, populli palestinez është zgjuar..... | 30 |
| 8- Nacionalizmi arab dhe çështja palestineze..... | 30 |
| KREU I PESTË: Paqja dhe dorëzimi..... | 32 |
| 1- Truku i paqes..... | 32 |
| 2- Projekti i dorëzimit të Palestinës përballë Izraelit..... | 33 |
| 3- Logjika e dorëzimit të arabëve përballë Izraelit..... | 35 |
| 4- Arsyeja e dështimit të kryengritjes së pare..... | 35 |
| 5- Rezultatet e projektit të dorëzimit në Oslo..... | 36 |
| 6- Tradhtia ndaj çështjes palestineze..... | 37 |
| 7- Tradhtia e Palestinës nga sundimtarët arabë..... | 38 |
| KREU I GJASHTË: Lufta dhe Rezistenca..... | 40 |
| 1- Fuqia e popullit..... | 40 |
| 2- Lufta heroike e popullit palestinez..... | 41 |
| 3- Boshti kryesor i luftës kundër regjimit sionist..... | 42 |
| 4- Modeli i muxhahidinëve palestinezë..... | 42 |
| 5- Xhahadi është detyrë e Bashkësisë Islame..... | 43 |
| 6- Kryengritja e Xhamisë Al Aksa..... | 44 |
| 7- Faktori i rilindjes palestineze (Kryengritja e Xhamisë Al Aksa)..... | 45 |
| 8- Palestina është boshti i zgjimit islam..... | 46 |
| 9- Rezistenca është kusht për çlirim..... | 47 |
| THËNIE TË NDRYSHME TË IMAM SEJID ALI KHAMENEIT PËR PALESTINËN..... | 49 |

فلسطين و أهميتها
في فكر
الإمام الخميني

تيرانا 2023

اسم الكتاب: فلسطين و أهميتها في فكر الإمام الخامني

المؤلف: السيد الإمام علي الخامني

المترجم: الحاج الشيخ ولنت مريا

التصحيح الأدبي: پروفيسور دكتور خيرى شهو

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

تصميم الغلاف: اسراء مريا

الاخراج النهائي: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا